



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE
SEKTORI I TRAJNIMIT DHE KONSULTIMIT

URDHËR I BRENDSHËM

Bazuar në manualin për “Përcaktimin e rregullave, kritereve dhe procedurave për shpalljen e pozicioneve të vendeve vakante në administratën e AMVV-së”, nr 316, datë 22.05.2024, i cili është hartuar sipas rregullores së brendshme të AMVV –së, shpallen vendet vakante për lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë për pozicionet si më poshtë:

Pozicioni i vendit vakant të punës

1. **“Përgjegjës” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion. Klasa e pagës III-2**
2. **“Specialist” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion. Klasa e pagës IV-2**

1. **Për pozicionin “Përgjegjës” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion, Klasa e pages III-2**

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
- Të zotëroj gjuhën Angleze të folur dhe të shkruar;
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë Master Shkencor në Shkenca Ekzakte, (Statistikë, Matematikë, Ekonomik, Informatikë)
- Të ketë eksperiencë punë të paktën 2 vite të lidhur me përpunim dhe analizim të dhënash.

Detyrat e përgjithshme të Përgjegjësit në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës:

1. Drejton të gjithë aktivitetin e sektorit dhe përgjigjet për performancën profesionale të sektorit të tij;
2. Të marrë masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo punonjës në veçanti dhe si sektor brenda planifikimit të detyrave të Agjencisë;
3. Të hartojë në fillim të çdo viti planin 6-mujor, si dhe planin vjetor duke marrë aprovimin e drejtorit të drejtorisë, si dhe të marrë masa për zbatimin e tij;
4. Të evidentojë problematikat që dalin nga veprimtaria e përditshme, problematikat e dala nga punonjësit e administratës, institucionet bashkëpunuese, si dhe grupet e interesit duke përcaktuar zgjidhjet e mundshme brenda kuadrit ligjor në fuqi dhe t'ia propozojë këto Drejtorit të Drejtorisë;
5. Të organizojë në bashkëpunim sistemin e informacionit për sektorin që mbulon;
6. Përgjigjet për progresin e punës së kryer dhe problematikat përpara Drejtorit të Drejtorisë;
7. Merr pjesë në takime pune, grupe dhe aktivitete të tjera sipas delegimit nga eprori;
8. Të bëjë vlerësime pune për punonjësit e sektorit në periudha 6-mujore dhe vjetore;
9. Përgjegjësi i sektorit kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga Drejtori i Drejtorisë ose titullari, aktet ligjore dhe nënligjore.

Detyra specifike të Përgjegjësit në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës:

1. Harton dhe shpërndan metodologjinë për mbledhjen e të dhënave për sistemin e matjen së performancës (SMP);
2. Harton strategjinë e trajnimit të Njesisë së Performancës së bashkive dhe kryen trajnimet sipas planit të punës;
3. Grumbullon, përpunon dhe analizon të dhënat nga NJVV dhe bën dokumentimin e aktivitetin.
4. Harton dhe shpërndan formate standarde për grantin e bazuar në performancë (GBP);
5. Harton Raportin Kombëtar të Performancës;
6. Komunikon dhe bashkërendon gjetjet e Raportit të SMP dhe procedurave të GBP sipas sektorëve me Ministritë e linjës përkatëse;
7. Siguron publikimin e Raportit të SMP dhe procedurave të GBP në faqet zyrtare;
8. Përgatit materiale për konferencën kombëtare të rezultateve të SMP dhe GBP.

2. Për pozicionin “Specialist” në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës, 1 pozicion.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të pozicionit të punës:

- Të jetë shtetas Shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës;
- Të zotëroj gjuhën Angleze të folur dhe të shkruar;
- Të ketë mbaruar arsimin e lartë Bachelor, Master Profesional ose Shkencor në Shkenca Ekzakte, (Statistikë, Matematikë, Ekonomik, Informatikë)

Detyrat e përgjithshme të Specialistit në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës:

1. Kryen me përpikmëri dhe nivel të lartë profesional brenda afateve, të gjitha detyrat që i ngarkohen nga përgjegjësi i sektorit, Drejtori i drejtorisë apo Drejtori i Përgjithshëm;
2. Bashkëpunon me kolegët për realizimin e detyrave të sektorit në kohë dhe me cilësi.
3. Vendos kontakte me përfaqësues të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në funksion të mbledhjes së të dhënave dhe ofrimit të ndihmës.
4. Merr pjesë në trajnime që lidhen me plotësimin më të mirë të detyrës dhe rritjen e vazhdueshme të nivelit të tij profesional dhe integritetit.
5. Respekton të gjitha rregullat dhe dispozitat ligjore për administrimin dhe ruajtjen e dokumenteve dhe aseteve të institucionit që ka në përdorim.
6. Merr pjesë në grupe pune të agjencisë, ose ndërinstitutionale, realizon vizita pune në NJVV-të sipas përcaktimit të drejtuesit dhe përcjell në mënyre aktive pozicionin e institucionit në
7. Plotëson brenda afateve të kërkuara komunikimin zyrtar, shkresor apo elektronik, sipas adresimit të drejtuesit.
8. Harton dhe përgatit raporte për çështjet dhe problematikat që rrjedhin nga detyrat funksionale të sektorit dhe informon eprorët për ecurinë e punës.
9. Kryen çdo detyrë tjetër që i caktohet nga Përgjegjësi i Sektorit, gjithmonë në lidhje me fushën e veprimtarisë së sektorit ku bën pjesë.

Detyrat specifike të Specialistit në Sektorin e Performancës, në Drejtorinë e Statistikës dhe Performancës:

1. Përgatit përkufizime dhe pasaportën për të gjithë setit të të dhënave të sistemit të matjes së performancës në nivel qendror;
2. Përgatit materialet e trajnimit në kuadër të SMP për njësitë e performancës të bashkive;
3. Siguron përditësimin e të gjithë sistemit të treguesve të performancës periodikisht por jo më pak sesa një herë në vit;
4. Përpunon, analizon dhe harton gjetjet e sistemit të matjes së treguesve të performancës;
5. Jep kontribut në hartimin e raportit vjetor kombëtar të performancës së NJVV duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkitë si dhe të dhënat zyrtare nga institucionet qendrore;
6. Përgatit raporte të ndryshme sipas nevojës së AMVV dhe MSHPV, apo kërkesave nga institucionet e qeverisjes qendrore;

Pozicionet e shpallura më sipër i ofrohen fillimisht nëpunësve të miratuar në organikën e AMVV-së për lëvizje paralele, dhe vetëm pas përfundimit të kësaj procedure në rast se ngelen vende vakante, u lind e drejta konkurrentëve nga jashtë për të vazhduar procedurën e përzgjedhjes për pozicionet vakante. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve brenda strukturës së AMVV dhe konkurrentëve nga jashtë bëhet njëkohësisht.

- **Listën e dokumentave që duhet të paraqesin:**

Fotokopje e të gjithë dokumentave që vërtetojnë përmbushjen e kriterëve të kërkuara për pozicionin vakant.

- a) Kërkesën për punësim, për pozicionin vakant;
- b) Jeteshkrim (CV);
- c) Fotokopje të noterizuar të diplomave dhe listave të notave;
- d) Fotokopje të librezës së punës;
- e) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f) Certifikate Familjare
- g) Vertetim të gjendjes shëndetësore;
- h) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- **Afatin dhe vendi i dorëzimit të dokumentave:**

Afati i fundit i dorëzimit të dokumentave është data **31.12.2025 ora 12:00** pranë protokollit të AMVV-së, në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Ish-Hoteli i Oficerëve, kati VII, Tiranë.

- **Procedurën dhe kriteret e përzgjedhjes:**

Konkurimi përfshin dy faza:

- a) Faza e parë konsiston në verifikimin nëse dokumentacioni i paraqitur nga çdo kandidat vërteton plotësimin e kërkesave të përgjithshme dhe/ose të veçanta në shpalljen për konkurim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, i nënshtrohen fazës të mëtejshme të konkurrimit.
- b) Faza e dytë është faza e intervistimit të kandidatëve të kualifikuar, e cila synon të evidentojë formimin profesional të kandidatëve dhe përzgjedhjen e kandidatit me rezultatet më të larta.
- c) Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, kualifikimi i tyre për fazën e dytë duhet të realizohet brenda 2 ditëve punë nga njësia e burimeve njërëzore dhe të proçedohet me njoftimin për kandidatët, të cilët nuk janë kualifikuar për fazën e dytë të konkurrimit.
- d) Afati i ankimimit dhe shqyrtimit të ankimimit të kandidatëve, të cilët nuk janë kualifikuar për të vazhduar fazën e intervistës është 5 ditë nga marrja e njoftimit për s'kualifikim. Në këtë rast njësia e burimeve njërëzore të institucionit, shpall listën e kandidatëve për të vijuar me intervistën brenda 5 ditëve pune. Afati 5 ditor është gjithashtu afati brenda të cilit duhet të shqyrtohen ankesat nga kandidatët e s'kualifikuar, si dhe të kthehet përgjigje.
- e) Caktimi i datës dhe vendit të intervistës bëhet pas afatit 2 ditor të verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët dhe kualifikimi i tyre për fazën e dytë, atë të intervistimit.
- f) Totali i pikëve të kandidatit është 100, të cilat ndahen përkatësisht: 50 pikë për jetëshkrimin, eksperiencën, pastërtinë e figurës dhe 50 pikë për intervistën me gojë.
- g) Shpallja e fituesve realizohet brenda 4 ditëve punë nga përfundimi i intervistës.
- h) Kandidati duhet të vlerësohet me të paktën 70 pikë për tu kualifikuar.
- i) Fitues shpallet kandidati që ka fituar pikët më të larta.
- j) Pas shpalljes së fituesit lidhet kontrata e punës.